



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-149
Prishtinë, 26 dhjetor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 26 DHJETOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ganimete Musliu, Arben Gashi, Albin Kurti, Teuta Haxhiu, Goran Marinković, Blerta Deliu-Kodra, Alma Lama, Albulena Haxhiu, Zenun Pajaziti dhe Vjosa Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Salihe Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashić në lidhje me kohën kur do të fillojë pagesa për pagat e personave të verbër, e garantuar me ligjin në fuqi. Ministri Nenad Rashić iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Goran Marinković parashtoi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me afatet kohore për përfundimin e ndërtimit të largpërçuesit të rrymës elektrike në komunën e Graçanicës, në mënyrë që KEDS-i t'i kryejë obligimet e veta sipas marrëveshjes së paraparë. Ministri Fadil Ismajli iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputetja Albana Gashi parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me arsyen e mosarritjes së marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë

për sqarimin e dyshimeve lidhur me mbetjet e personave të paidentifikuar në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputeti Burim Ramadani parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me të dhënat e MPB-së për dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës për vitin 2013 dhe çka është ndërmarrë për luftimin e kësaj dukurie.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Burim Ramadani.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se pse gjatë këtyre viteve nuk është bërë rritja e shumës që jepet si ndihmë sociale.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Ganimete Musliu parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a është në dijeni ministria që ai drejton për një rast ku në Repartin e Kirurgjisë Vaskulare një pacient ka qëndruar pesë orë në sallën e operacionit për shkak të neglizhencës së personelit mjekësor.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Ganimete Musliu parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me mosdeklarimin e Ministrisë së Drejtësisë për rastin e marrjes në pyetje të kryetarit të Kuvendit nga EULEX-i.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me ndarjen e pasurive të paluajtmshme për ligjëruesit e UP-së në kohën kur rektor i këtij institucioni ishte Zejnel Kelmendi.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës për fjalë u paraqitën deputetët: Ismet Beqiri dhe Adem Grabovci.

Ismet Beqiri propozoi që pika - *Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian* të renditet për shqyrtim si pikë nr. 3 e rendit të ditës së punimeve të sotme.

Fjala e plotë e deputetit Ismet Beqiri është dhënë e plotë në transkript.

Adem Grabovci propozoi që në rendin e ditës të punimeve të mbledhjes së sotme të hyjnë pikat: Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së.

* * *

Në vazhdim, kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të deklarohen lidhur me propozimin e Ismet Beqiri.

Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Ismet Beqiri që pika - *Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian* të renditet për shqyrtim si pikë nr. 3 e rendit të ditës së punimeve të sotme.

* * *

Në lidhje me propozimin e deputetit Adem Grabovci, kryetari kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e deputetit Adem Grabovci u deklaruan deputetët: Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, dhe Goran Marinkoviq, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Adem Grabovci.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër -----51
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Adem Grabovci për futjen në rend të ditës të pikave - Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75 % të aksioneve të PTK-së.

Kryetari tha se këto dy pika radhiten për shqyrtim si pika me numrin rendor 8 dhe 9.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
8. Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së,
9. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së.

3. Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LDK-së e ka propozuar deputeten Vjosa Osmani për kryetare në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian, në vend të ish-deputetit Lutfi Haziri.

Ndërsa deputetja Alma Lama, propozohet anëtare e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartshënuar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetja Vjosa Osmani emërohet kryetare e Komisionit për Integritet Evropian, në vend të ish-kryetarit të këtij komisioni, Lutfi Haziri.

2. Deputetja Alma Lama emërohet anëtare e Komisionit për Integritet Evropian.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, kryetari tha se fjalën e ka kërkuar ministri i Financave Besim Beqaj.

Besim Beqaj, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se e tërheq amendamentin nr. 8 në këtë projektligj, të paraqitur nga Qeveria.

Fjala e plotë e ministrit Besim Beqaj është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funkcional e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Diskutimi i deputetes Hadërgjonaj është dhënë i plotë në transkript.

Deputetja Albana Fetoshi diskutoi në lidhje me amendamentin nr. 5.

Diskutimi i plotë i deputetes Albana Fetoshi është dhënë në transkript.

Deputeti Hydajet Hyseni diskutoi në lidhje me amendamentin nr. 7.

Diskutimi i plotë i deputetit Hydajet Hyseni është dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet:1, 2, 3, 4A, 5A, 6, 7A, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44A, 45 dhe amendamentin nr. 46.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 4B, 5B, 7B dhe amendamentin nr. 47.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitit 2014, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 48,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2014.

* * *

Në vazhdim, lidhur me procedimin e votimit të amendamenteve nr. 7A dhe 7B të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 diskutoi deputeti Hydajet Hyseni, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari Jakup Krasniqi lidhur me këtë çështje tha se kjo i përket Komisionit FunkSIONAL dhe diskutimi i ngritur nga deputeti Hydajet Hyseni për këtë amendament është dashur të sqarohet paraprakisht në atë komision. Diskutimi i kryetarit është dhënë i plotë në transkript.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e paraqiti deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi edhe deputeti Daut Haradinaj, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14,15, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi edhe deputeti Arben Gashi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë.

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthimin në Kuvend të Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa e paraqiti dhe e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Më pas, kryetari i hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1 dhe 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen amendamentet 1 dhe 2, të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sipas vërejtjeve të Presidentes së Republikës së Kosovës, në Ligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

2. Me ndryshimet e miratuara, Ligji konsiderohet i shpallur.

8. Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së, të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të AAK-së e lëshuan sallën e mbledhjeve plenare.

Më pas, kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 54 deputetë dhe se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin e kësaj pike.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti Fatmir Limaj, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa për përfundimin e sesionit vjeshtor të vitit 2013 do të vendoset në mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 16:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale